



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njesia Org. Org.Jedinica Org Unit	09	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-4880
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	-18-	Data: Datum: Date:	21/06/2024
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

## KONTRATË

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 206-24-4028-2-2-1/C670

## SHËRBIME

**“Hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë”**

Numri i prokurimit: 206-24-4028-2-2-1

**Grup i Operatorëve Ekonomik: GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.;**  
**STUDIO HAPSIRA SH.P.K.**

**NUI: 812113463**

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

# KONTRATË

Numri i kontratës<sup>2</sup>: 206-24-4028-2-2-1/C670

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.; STUDIO HAPSIRA SH.P.K., Ndue Përleshë B2-1/6- Mat 1, p.n, Prishtinë, , (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë**  
me numër identifikues: 206-24-4028-2-2-1

## Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

**Hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë**

No.	Lot
1	Hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë

## Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **7,899.00 €**; [*Shtatëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetenëntë*] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	TVSH	Çmimi për njësi me TVSH
1	Hartimi i projektit „Adaptimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë”, sipas Detyrës Projektuese me të gjitha fazat, duke përfshirë edhe projektimin e hapësirës së jashtme-parterit.	cope	1	6,694.07	1,204.93	7,899.00

## Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- Sigurimi i ekzekutimit.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>2</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>3</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

#### Për Autoritetin Kontraktues

#### Për Furnizuesin

<b>Emri:</b>	<b>Berat Marmullaku</b>	<b>Emri:</b>	<b>BESA ET HALIMI</b>
<b>Pozita:</b>	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	<b>Pozita:</b>	<b>DDG TOR</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>20.06.2024</b>	<b>Data:</b>	<b>20.06.2024</b>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 206-24-4028-2-2-1/C670

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe **“Palët”** nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

---

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktuar pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shumën e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të fillojë shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrin ~~me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.~~

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjisllacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndryshimi nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndryshimi do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

## **Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13 Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbris dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## **Neni 14 Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

---

## **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## **Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrë të duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të



përçindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17            Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18            Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19            Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/ose

---

b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) Dëme të përgjithshme; ose

b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20            Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

## **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

---

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 206-24-4028-2-2-1/C670

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [Shqipe].
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 5 dite pas nënshkrimit të kontratës
	6.4	Data e Përfundimit është [60 dite].
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është [Prishtine]
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është [shëno emrin, adresën e Menaxherit të Projektit]
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % ne ditë Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është [10% ] të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% vlerës së kontratës me kohëzgjatje prej 90 dite.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: [pas përfundimit të shërbimeve me pranimin e raportit të kryerjeve të shërbimit]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

**ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME  
DETYRA PROJEKTUESE**

**INVESTITOR: MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

**“ADAPTIMI I OBJEKTIT TË MARRUR ME QERA NGA AKP, PËR ZYRA TË FARMACISË DEPO  
QENDRORE TË BARNAVE DHE ASGJËSIMIN E PRODUKTEVE MEDICINALE”**

**HYRJE**

Me qëllim të akomodimit të zyrtarëve të Divizionit të Farmacisë, të krijimit të kushteve dhe hapësirave për Depo Qendrore të ruajtjes së barnave, si dhe krijimit të kushteve dhe hapësirave për Depo që ruhen deri në asgjësim të tyre është e domosdoshme Detyra projektuese për adaptim të këtyre hapësirave sipas nevojës së institucionit.

**QËLLIMI**

Qëllimi i hartimit të projektit egzekutiv është adaptimi i objektit i cili do të merret nga Agjencia Kosovare e Privatizimit për shfrytëzim të Ministrisë së Shëndetësisë konkretisht për zyra të Divizionit të Farmacisë, Depo Qendrore të barnave dhe për depo për ruajtjen e barnave jashtë përdorimit (te papërdorshme).

---

**SFONDI**

Aktualisht të gjitha produktet dhe pajisjet medicinale deponohen ruhen në kushte jo të favorshme dhe jo konform praktikave të mira farmaceutike. Objekti ekzistues nuk plotëson kushtet për ruajtje dhe distribuim sipas standardeve të parapara, andaj për rrjedhojë ka lindur nevoja e gjetjes së marrjes së një objekti / depe për shfrytëzim për ruajtjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Gjithashtu hapësirat ku është aktualisht stafi aktual i Divizionit të Farmacisë i vendosur në MSh nuk plotëson kushtet hapësinore për punë. Gjithashtu, adaptimi i zyrave për stafin do të jetë sa më afër depe me qëllim të menaxhimit të mirë të pranimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Devoja aktuale e Ministrisë së Shëndetësisë gjithashtu shërben edhe për ruajtjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale të konfiskuara nga inspektorati farmaceutik si dhe pasjeve dhe produkteve medicinale të ardhura si donacione që nga paslufta e këtij dhe kjo e bënë të pamundur funksionimin e depeve qendrore aktuale.

Objektivë e planit të veprimit është adaptimi i objektit të marrur me qira nga AKP, depo qendrore të barnave, për zyra të farmacisë, dhe asgjësimin e produkteve medicinale.

**Objektivi Strategjik:** Në kuadër të projektit detaj të parashihet adaptimi dhe përshtatja e objektit për zyra të farmacisë, depo qendrore të barnave dhe ruajtjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale të pa përdorshme deri në asgjësimin e tyre.

## LOKACIONI

Objekti i cili është paraparë për adaptim gjendet ne rrugën nacionale Prishtinë – Fushë Kosovë, përkthsisht në rrugën “Aziz Abrashi”. Objekti është i vendosur në kuadër të ngastrave kadastrale **01504-16** dhe **01504-17**. Totali I dy ngastrave ka sipërfaqe prej rreth **6,220 m<sup>2</sup>**. Objekti ekzistues me etazhitet **P+1** ka sipërfaqe në bazë prej rreth **1135.26 m<sup>2</sup>**.



Objekti ka etazhitet P+1 me këto përmbajtje :

Në Katin Përdhësë janë të vendosura dy hapësira-zyrë, dy tualete si dhe katër depo të madhësive të ndryshme. Sipërfaqja e përdhësës është 1135.26m<sup>2</sup>.

Kati i parë përmban shtatë hapësira-zyrë, dy tualete si dhe korridoret, të cilat në total kanë sipërfaqen prej 250,17 m<sup>2</sup>.

Objekti ka dy hyrje kryesore si dhe tri hyrje anësore.

## PROJEKTI IDEOR

Zgjidhja ideore për projektin, duhet të përfshijë:

- Projektuesi në kuadër të hartimit të projektit duhet ti trajtojë të gjitha hapësirat e objektit dhe nëse ka nevojë për ndryshime eventuale ti paraqes ato për miratim para investitorit.
- Projekti duhet të hartohet në bashkëpunim të plotë me autoritetin kontraktues.
- Projektuesi duhet që të bëjë analizën e strukturës ekzistuese të objektit, të jep rekomandimet përkatëse dhe vlerësimin për gjendjen e strukturës së objektit të cilat duhet të jenë pjesë e projektit të strukturës.
- Pas analizës së strukturës ekzistuese, të bëhet ndarja e një hapësire në dy etazhe përmes konstruksionit metalik, varësisht nga kërkesat e investitorit.
- Organizimin e hapësirave të brendshme dhe funksionalitetin e tyre.
- Organizimin e hapësirave të jashtme brenda parcelave, duke përfshirë gjithashtu përmbajtjet në parcelë.

- Në projektin e renovimit duhet të planifikohet rrethoja e oborrit si dhe shtrimi dhe rregullimi i oborrit për manipulimin dhe lëvizjen e veturave, kamionëve dhe makinerive tjera transportuese.

Për ndërtesën në fjalë ekziston vetëm Planifikimi i sipërfaqeve i prezantuar në këtë dokument, si detyrë projektuese.

#### **Referencat e obligueshme**

- Ligji i Ndërtimit 04/L-110
- Udhëzimi Administrativ MMPH\_06\_2017
- Ligji Nr04L/190për Produkte dhe Pajisje medicinale
- Udhëzimi Administrativ (MSh) NR.03/2013 Qarkullusit me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale
- IHFG – International Health Facility Guidelines <http://healthfacilityguidelines.com>

#### **Referencat Opsionale**

- NHS Health Building Notes (HBN)
- FGI Guidelines

### **KËRKESAT – PROGRAMI I HAPËSIRAVE**

#### **Depo Qendrore – rreth 1500 m<sup>2</sup>**

- Sektori i Barnave të jetë rreth **400 m<sup>2</sup>**, pajisur me inventar - rafta metalik.
- Sektori i Narkotikëve dhe Citostatikëve të jetë rreth **25 m<sup>2</sup>**, pajisur me inventar- rafta metalik.
- ~~- Dhoma e ftohtë të jetë rreth **40m<sup>2</sup>**, inventari: rafta dhe frigorifer~~
- Sektori i Materialit Medicinal të jetë rreth **900m<sup>2</sup>**- pajisur me inventar- rafta për paleta.
- Dy hapësira per ruajtjen e produkteve të skaduar dhe të konfiskuara, me sipërfaqe rreth **100 m<sup>2</sup>** – pajisur me inventar - rafta metalik.
- Ashensor Industrial

#### **Pjesa administrative**

- Zyret administrative (5)
- Zyra e pranimit (1)
- Hapësira për mbledhje (1)
- Kuzhina dhe qëndrimi ditë (1)
- Nyjet sanitare të nevojshme
- Arkiva e MSH me sipërfaqe rreth.100m<sup>2</sup>

Tri njësitë duhet të kenë hyrje të veçanta dhe të muret parasysh mos përzjerja e funksioneve.

#### **Vërejtje:**

- Të bëhet inçizimi detal i gjendjes ekzistuese duke përfshirë të gjitha përmbajtjet brenda dhe jashtë objektit, që përfshinë identifikimin e të gjitha instalimeve ekzistuese në parcela.
- Nuk do të procedohet me Projektin Zbatues pa u dakorduar me palët e përfshira për zgjidhjen e projektit ideor.

- Kompania projektuese do të merr parasysh që gjatë procesit të projektimit mund të dalin kërkesa jashtë detyrës projektuese dhe të njëjtat do të trajtohen bashkarisht me palët e përfshira.
- Të bëhet analiza e strukturës së objektit ekzistues.

#### **PROJEKTI KRYESOR:**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të propozojë edhe zgjidhje inovative duke respektuar normat dhe praktika më të mira në projektim dhe zbatim të projekteve, në rastet kur paraqiten këto rekomandime duhet që të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe kostot financiare.

Projektuesi gjatë hartimit të projektit duhet të paraqesë para investitorit për miratim materialet e përdorura në projektim të cilat duhet ti përmbushin kriteret e cilësisë dhe konformitetit për të gjitha elementet e projektit.

- Projekti detal arkitektonik të renovimit dhe adaptimit
- Projekti i Inventarit me specifika teknike dhe vizatime
- Projekti I elektrikës
- Projekti I ujësjellsit dhe kanalizimit me të gjitha pjesët përcjellëse
- Projekti për makineri -ngrohje, klimatizim dhe ventilim.
- Elaborati për mbrojtjen kundër zjarrit.

---

#### **Detyra projektuese për Pjesën elektrike**

- Inçizimi i gjendjes të Instalimeve furnizuese ekzistuese prej TS-it. Zgjidhja për furnizim të ipet varësisht nga kapaciteti elektrik i nevojshëm për funksionalizim të objektit dhe varësisht nga gjendja e instalimeve ekzistuese të 0.4 dhe 10(20)kV. Inçizimi i trasese dhe projektimi i instalimit elektrik per kabllot furnizuese nga trafo dhe gjeneratori,
- Projektimi i instalimeve të rrymave të forta nga furnizimi i rrjetit 0.4kV të qytetit,
- Projektimi i instalimeve të ndriçimit të jashtëm,
- Projektimi i instalimeve të rrymave të forta me UPS dhe gjenerator,
- Projektimi i instalimeve të rrjetit IT/tel,
- Projekti elektrik per instalimet e sistemit të alarmit kundër zjarrit
- Projektimi i instalimeve të sistemit të sigurisë CCTV Security sistem. Në këtë sistem të përfshihen siguria në objekt, në hapësirat e oborrit si dhe në pjesët përreth oborrit.
- Projekti elektrik per paisjet makinerike si: ujit sanitar, ngrohje, klimatizim dhe ventilim
- Baza e Planimetrisë, P=1:50
- Skemat elektrike, P=1:50
- Detalet, P=1:25

#### **Detyra projektuese për hidroinstalime**

- Analizë e detajuar e drenazhimit ekzistues të objektit. Varësisht nga gjendja, të parashihet drenazhim i ri i objektit.
- Të analizohet gjendja në infrastrukturën ekzistuese për ujësjellës dhe kanalizim të ujërave të zeza dhe atmosferike. Varësisht nga rezultatet, të parashihen edhe kyqjet e reja.
- Projektimi i instalimeve të brendëshme për hidro, përfshirë edhe ujin sanitar të ngrohtë.

#### **Detyra Projektuese për Pjesën Makinerike**

- Inçizimin detal i gjendjes ekzistuese I të gjitha përmbajtjeve ekzistuese në lokacionin ku bëhet investimi (inçizimi I infrastrukturës),
  - Dizajnimi-dimensionimi I paisjeve për sistemin e klimatizimit dhe ventilimit, (paisjen ftohëse, paisjet për ventilim, rrjetin shpërndarës për ventilim) me të gjitha paisjet përcjellëse
  - Dizajnimi-dimensionimi i paisjeve për sistemin e ngrohjes (rrjetin shpërndarës, trupat ngrohëse, pompat qarkulluese, valvolat, rregullimin e sistemit) me të gjitha paisjet përcjellëse duke inçizuar dhe analizuar pikën e kyqjes,
  - Dizajnimi-dimensionimi i paisjeve për sistemin e ujit sanitar (rrjetin shpërndarës, pompat qarkulluese, valvolat, rregullator të sistemit) me të gjitha paisjet përcjellëse duke inçizuar dhe analizuar pikën e kyqjes.
  - Përshkrimi teknik i projektit duke përfshi specifikat teknike të materialeve dhe paisjeve sipas standardeve
- 
- Paramasa dhe parallogaria,
  - Caktimi i kushteve tekniko - profesionale,
  - Baza e Planimetrisë. P=1:50,
  - Skema teknologjike P= 1:50,
  - Detalet, P= 1:25

#### **Pjesa Tekstuale:**

- Përshkrimin teknik të hollësishëm duke përfshirë edhe kushtet e mirëmbajtjes,
  - Paramasën dhe parallogarinë për fazat e projektimit :Arkitekturë, Llogari statike, Ujësjellës e kanalizim; Elektrikë;Makineri: ventilimi dhe klimatizimi.
- Projekti duhet të përmbajë: Situacionet, Bazat , prerjet , fasadat në përpjesë 1:50 ; detalet e pozicioneve karakteristike sipas kërkesës së AK në përpjesë 1:20; 1:10 si dhe skemat e nevojshme të dyerve dhe dritareve, elektrikës, klimatizim dhe ventilim si dhe të hidroinstalimeve.
- Kompania projektuese do të jetë bashkëpunëtorë profesionale duke u përgjigjur në kërkesat e MSH deri në adaptimin dhe funksionalizimin e objektit.



Dokumentacioni tekniko investiv - projektues te hartohet ne harmoni me dokumentet dhe rregullativen ligjore ne funksion te adaptimit të objekteve të kësaj natyre.

### **Vërejtje**

Dokumentacioni i përgjithshem duhet te prezentohet ne forme tekstuale dhe grafike kopje fizike dhe digjitale.

- Projekti detal-zbatues duhet të dorëzohet në 5 kopje fizike si dhe 5 elektronike për të gjitha fazat e projektimit, ne programin e projektuar (i editueshem), PDF format, excel, word etj. Versioni digjital ne kopje te mjaftueshme me dokumentacionin per pergaditje te tenderit dhe menaxhimin e projektit me paramasë dhe parallogari të të gjitha fazave e rekapituluar në format excel.

### **Dinamika e kompletimit të Dokumentacionit Teknik:**

I tërë aktiviteti i kompletimit të projektit dhe dokumentacionit adekuat teknik për realizim të projektit –  
**“ADAPTIMI I OBJEKTIT TË MARRUR ME QERA NGA AKP, PËR ZYRA TË FARMACISË,  
DEPO QENDRORE TË BARNAVE DHE ASGJËSIMIN E PRODUKTEVE MEDICINALE”**  
duhet të jetë i kompletuar për max. 60 ditë kalendarike.

---

CERTIFIKATË SIGURIMI PËR GARANCINË E KONTRATAVE  
(UVERENJE OSIGURANJA ZA GARANCIJU UGOVORA)

Nr i Policës / Br.Polise / Policy No. 070011440007890

Nr Serik / Serijski br. / Serial num. 7890

Garantuesi / Davalac garancije / Warrantor:	Kompania e Sigurimeve Siguria		
Adresa / Adresa / Address:	Rr. Luan Haradinaj Prishtine		
Përfaqësia / Predstavništvo / Branch Office:	PRISHTINË		
Agjenti / Agent / Agent:	Lendita Krasniqi		
Banka e Garantuesit / Banka davalaca garancije / Warrantors Bank:	Banka Ekonomike		
Nr. Xhirollogarise / Br.Žiroračuna / Account No:	140100000850384		
Kontraktuesi / Ugovorač / Contractor:	GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.		
NRB / BRN:	812113463 - 812113463		
Adresa / Adresa / Address:	Ndue Përlleshi		
Përfaqësuar nga / Predstavljen od / Represented by:			
	Përshkrimi i aktivitetit / Kontratës që është objekt i Kontratës së Garancisë / Description of the activity / Contract - the subject matter of the performance bond / Opis aktivnosti / Ugovora koji je objekat Garancije		
Titulli i Kontratës / Naslov ugovora / Contract Title:	Hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe zyra të Farmacisë"		
Numri Referencës / Br.preporuke / Licenses Reference Number:	206-24-4028-2-2-1		
Përfituesi / Korisnik / Beneficiary:	MINISTRIA E SHENDETESISE		
Adresa / Adresa / Address:	RR. E ZAGREBIT P.N. ARBERI - PRISHTINE		
Shuma e Garantuar / Garantovani iznos / Guaranteed Sum:	790.00 €		
Periudha e Garancisë / Period Garancije / Period of Guarantee:	20.6.2024	Deri më / Do / Until	19.10.2024
Primi / Premija / Premium:	Primi / Premija / Premium	TVSH / PDV / VAT	TOTALI / UKUPNO / TOTAL
Data / Datum / Date: 20.6.2024	20.00 €	3.60 €	23.60 €

Certifikata e garancisë është e vlefshme kur bashkëlidhur me të gjendet kontrata e garancisë e cila përmban kushtet e sigurimit të garancisë dhe që së bashku me formën propozuese janë pjesë përbërse e certifikatës së garancisë. Garantuesi K.S. SIGURIA merr përsipër që në rast se kontraktuesi nuk u përgjigjet detyrimeve të tijë PËRFITUESIT të shumës së garantuar të plotësojë detyrimet deri në shumën e garantuar siq përcaktohet në këtë certifikatë dhe në kushtet e kontratës mbi bazën e të cilës lëshohet kjo certifikatë Garancie. Garantuesit me përmbushjen e detyrimeve të Kontraktuesit ndaj Përfituesit të garancisë, i lind e drejta që të veprojë kundrejt Kontraktuesit (cedimi i së drejtës) në të njëjtën mënyrë siq do të kishte vepruar përfituesi i garancisë në rastin kur kjo CERTIFIKATË GARANCIE nuk do të ishte lëshuar.

Uverenje garancije je važeće kada u prilogu se nalazi i ugovor garancije koji sadrži uslove osiguranja garancije koja zajedno sa predlagačkom formom su sastavni deo uverenja garancije. Davalac garancije K.O.SIGURIA obavezuje se da u ukoliko ugovorač se ne odaziva obavezama, KORISNIK garantovanog iznosa će ispuniti obaveze do garantovanog iznosa kao što se utvrđuje ovim uverenjem i uslovima ugovora na osnovu kojeg se izdaje ovo uverenje garancije. Davaocu garancije ispunjavanjem obaveza Ugovorača prema Korisniku garancije, daje se pravo da deluje prema Ugovoraču (povreda prava) na isti način kako bi delovao korisnik garancije u slučaju da ovo UVERENJE GARANCIE ne bi bilo izdato.

Performance Bond certificate is valid when attached to it is the Warranty Contract which contains general conditions of the Performance Bond, so that together with the proposal form composes structural part of the Performance Bond certificate. Warrantor I.C. SIGURIA guarantees that in case if contractor will not respond to his duties and responsibilities towards the Beneficiary of the guaranteed sum to fulfill those duties up to the guaranteed sum as specified in this certificate and in the general conditions of the contract, based upon the General Conditions for the issuance of this certificate of warranty. With the fulfillment of the duties of the Contractor towards the Beneficiary of this warranty. Warrantor has the right to act towards the contractor in the same manner as the beneficiary of the warranty would act in case that this Performance Bond Certificate would not be issued.

Garantuesi / Davalac garancije /  
WarrantorDepartamenti i marrjes ne Sigurim / Odeljenje za prijem  
osiguranja / Department of Insurance ReceiptsKontraktuesi / Ugovorač / Contractor:  
GEOPLAN&CONSULTING GROUP